


Tregtia e jashtme e mallrave

Nëntor 2024

Tiranë, më 17 Dhjetor 2024: Në Nëntor 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 30 mld lekë, duke u ulur me -8,5 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me -2,8 %, në krahasim me Tetor 2024. Importet e mallrave arritën vlerën 73 mld lekë, duke u rritur me 2,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me -5,0 %, në krahasim me Tetor 2024. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 43 mld lekë, duke u rritur me 10,9 %, krahasuar me Nëntor 2023 dhe duke u ulur me -6,5 %, në krahasim me Tetor 2024.

Fig.1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në këtë njëmbëdhjetmuor eksportet e mallrave arritën vlerën 347 mld lekë, duke u ulur me -13,9 % krahasuar me një vit më parë, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 816 mld lekë, duke u rritur me 2,0 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 469 mld lekë, duke u rritur me 18,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Nëntor 2024, në uljen e eksporteve prej -8,5 %, kanë ndikuar grupet: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -8,8 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -3,4 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me -1,7 pikë përqindje etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Ushqime, pije, duhan” me 2,5 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me 1,4 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me 0,4 pikë përqindje.

Për publikim 17/12/2024

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Nëntor 2024




Eksportet, gjatë këtij njëmbëdhjetmujori janë ulur me -13,9 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -5,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -4,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,7 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Nëntor 2024, në rritjen e importeve prej 2,0 %, krahasuar me Nëntor 2023, negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -0,8 pikë përqindje, , etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,5 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +1,2 pikë përqindje .

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Nëntor 2024



Si njëmbëdhjetmujor, importet janë rritur me 2,0 %, krahasuar me njëmbëdhjetmujorin e parë 2023. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,7 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +1,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa kanë ndikuar negativisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,2 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -0,9 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,3 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Nëntor 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Nëntor 2023 janë: Italia (6,8 %), Kosova (19,3 %), Greqia (2,6 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritje më të madhe, janë: Gjermania (17,8 %), Turqia (80,2 %), Kina (13,9 %).

Gjatë këtij njëmbëdhjetmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (13,6 %), Kosova (9,3 %), Greqia (19,0 %), etj. Ndërsa vendet me të cilin eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: Kina (16,6 %), SHBA (59,9 %), etj.

Në muajin Nëntor 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të importeve, janë: Turqia (0,8 %), SHBA (13,5 %), Maqedonia e Veriut (16,3 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur rritjen më të madhe në krahasim me Nëntor 2023 janë: Italia (2,4 %), Kina (15,4 %), Greqia (11,2 %), etj.

Gjatë këtij njëmbëdhjetmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Turqia (14,8 %), Kina (1,6 %), Greqia (19,1 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (2,7 %), Spanja (2,0 %), etj.

Fig.4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Nëntor 2024



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 57,9 %, të gjithë tregtisë. Në Nëntor 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 75,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 50,6% të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,9 %), Kina (9,4 %), Turqia (7,1 %), Gjermania (7,0 %).

Shkëmbimet tregtare, për njëmbëdhjetmujorin e parë 2024, me vendet e BE-së zënë 57,6 % të gjithë tregtisë, Në periudhën Janar – Nëntor 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 71,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 51,5 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (28,0 %), Kina (8,4 %), Turqia (8,0 %) dhe Greqia (7,2 %).

Tab.1 Qarkullimi i mallrave, Nëntor 2024

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2020		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2021		369	35,6	801	32,3	-432	46,1
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2021	01 - 21	24	3,1	45	8,4	-22	52,3
	02 - 21	25	-0,9	52	0,9	-27	47,4
	03 - 21	32	78,1	64	45,3	-33	49,2
	04 - 21	29	92,3	63	72,9	-34	45,6
	05 - 21	33	52,7	62	38,4	-29	53,0
	06 - 21	35	50,8	67	28,9	-32	51,9
	07 - 21	32	30,6	72	26,1	-39	44,8
	08 - 21	24	22,5	61	26,2	-37	39,0
	09 - 21	25	0,0	52	0,0	-27	48,2
	10 - 21	34	26,3	77	29,2	-43	44,3
	11 - 21	37	36,3	81	44,4	-43	46,3
	Jan-Nën 21	329	32,2	696	28,0	-367	47,3
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	08 - 22	35	48,1	80	30,8	-44	44,2
	09 - 22	39	52,5	88	67,6	-49	43,8
	10 - 22	38	12,5	83	8,6	-45	45,9
	11 - 22	42	12,9	77	-3,9	-35	54,4
	Jan-Nën 22	447	35,7	856	22,9	-409	52,2
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	09 - 23	34	-12,8	73	-16,6	-40	45,8
	10 - 23	37	-4,3	78	-6,3	-42	46,8
	11 - 23	33	-21,8	72	-7,4	-39	46,0
	Jan-Nën 23	403	-9,8	800	-6,5	-397	50,3
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5
	02 - 24	32	-16,1	74	6,4	-42	43,5
	03 - 24	33	-21,0	75	-7,0	-42	44,4
	04 - 24	35	1,8	75	0,6	-41	45,9
	05 - 24	35	-12,4	79	-1,6	-45	43,8
	06 - 24	35	-8,9	77	2,1	-42	45,3
	07 - 24	33	-12,0	85	21,1	-52	39,0
	08 - 24	22	-18,2	69	1,9	-46	32,6
	09 - 24	31	-8,5	71	-3,1	-40	43,3
	10 - 24	31	-15,2	77	-1,5	-46	40,3
	11 - 24	30	-8,5	73	2,0	-43	41,2
	Jan-Nën 24	347	-13,9	816	2,0	-469	42,5

Tab.2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Nëntor 2024

	Eksporte				Importe			
	Nëntor 2023	Nëntor 2024	Jan.- Nën. 2023	Jan.- Nën. 2024	Nëntor 2023	Nëntor 2024	Jan.- Nën. 2023	Jan.- Nën. 2024
Vendet e BE-së	24.643	22.774	293.760	248.993	36.700	36.975	408.670	420.423
Austri	191	153	4.006	2.242	597	610	7.465	7.192
Gjermani	1.722	2.028	21.413	20.384	4.979	5.237	56.042	58.514
Greqi	1.920	1.870	26.556	21.522	4.774	5.311	52.307	62.316
Itali	14.793	13.781	176.110	152.228	15.693	16.078	178.502	173.726
Spanjë	1.181	1.068	17.013	11.962	945	927	12.330	12.085
Kroaci	319	357	4.327	3.713	1.007	349	8.671	4.592
Të tjera të BE-së	4.517	3.517	44.336	36.941	8.704	8.464	93.352	101.999
Mbretëri e Bashkuar	143	104	6.298	1.367	873	733	7.977	8.742
Kinë	615	700	8.515	9.927	7.782	8.982	85.945	87.316
Kosovë	3.029	2.446	37.724	34.207	1.053	1.031	10.606	14.447
Maqedonia e Veriut	1.037	730	15.404	11.135	1.261	1.056	12.782	10.902
Rusi	-	-	8	7	311	287	4.029	3.622
SHBA	415	357	4.097	6.552	1.429	1.237	15.899	17.997
Turqi	399	720	4.826	4.331	6.628	6.574	77.141	88.572
Ukrainë	29	163	1.080	3.095	416	254	3.928	3.631
Zvicër	501	99	4.463	2.040	1.245	829	12.790	8.821
Të tjera	2.105	2.036	26.545	25.278	13.928	15.088	160.156	151.096
Gjithsej	32.917	30.128	402.720	346.931	71.626	73.044	799.924	815.570

Tab.3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë), Nëntor 2024

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Nëntor2023	Nëntor2024	Jan.- Nën.2023	Jan.- Nën.2024	Nëntor2023	Nëntor2024	Jan.- Nën2023	Jan.- Nën.2024
Gjithsej	32.917	30.128	402.720	346.931	71.626	73.044	799.924	815.570
Ushqime, pije, duhan	4.580	5.395	50.920	48.445	11.758	12.106	133.354	142.719
Minerale, lëndë djegëse, en, el,	4.535	4.664	86.373	65.625	8.408	7.190	94.059	84.136
Produkte kimike dhe plastike	1.611	1.046	14.799	14.167	8.590	9.482	104.643	105.835
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	179	178	2.447	1.875	1.008	893	12.783	10.704
Prodhime druri dhe letre	945	866	10.385	9.223	2.724	2.263	27.677	27.077
Tekstile dhe këpucë	10.470	9.346	117.283	97.845	8.036	7.278	86.839	79.487
Materiale ndërtimi dhe metale	6.689	3.781	73.226	62.283	9.892	9.305	112.571	111.192
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	2.970	3.419	36.347	35.018	18.151	19.972	194.493	216.107
Të tjera	939	1.433	10.942	12.449	3.057	4.555	33.504	38.313

Tab.4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Nëntor 2024

	Itali		Kosova		Greqi		Gjermani	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	176.110	152.228	37.724	34.207	26.556	21.522	21.413	20.384
Ushqim, pije duhan	13.989	12.949	5.988	5.840	4.344	4.000	1.931	1.778
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	9.289	12.530	7.366	8.583	8.166	2.838	6.876	5.315
Produkte kimike dhe plastike	5.775	5.180	3.767	3.729	988	855	50	70
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	2.228	1.593	8	6	76	156	22	1
Prodhime druri dhe letre	6.060	4.835	1.107	1.134	1.636	1.447	117	129
Tekstile dhe këpucë	90.982	73.305	194	159	6.429	7.298	8.884	8.628
Materiale ndërtimi dhe metale	23.130	19.780	15.816	11.716	3.898	3.990	1.402	960
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	19.627	17.220	1.955	1.814	135	227	1.788	3.075
Të tjera	5.031	4.836	1.522	1.225	884	712	343	427

Tab.5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Nëntor 2024

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	178.502	173.726	85.945	87.316	77.141	88.572	52.307	62.316
Ushqim, pije duhan	26.675	29.482	1.722	1.614	5.295	4.925	15.860	17.478
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	5.992	3.989	36	18	9.095	9.816	5.708	10.225
Produkte kimike dhe plastike	21.662	21.573	7.437	7.018	10.750	11.090	8.844	10.261
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	10.303	8.234	813	898	302	342	72	136
Prodhime druri dhe letre	6.274	5.618	1.820	1.881	4.317	4.264	3.686	3.709
Tekstile dhe këpucë	39.471	33.054	12.606	13.105	13.238	11.190	4.992	5.775
Materiale ndërtimi dhe metale	22.863	20.154	12.523	11.670	19.092	26.716	7.802	8.533
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	37.524	40.312	42.089	43.274	11.340	16.423	3.657	4.064
Të tjera	7.739	11.309	6.900	7.838	3.711	3.806	1.687	2.135

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejitimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituan, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri